

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Miku i Serbisë, "lot" për UÇK
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/miku-i-serbise-lot-per-uk-i586712
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:50:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4dfa2c9b30e117510ba47a087b423755ed60bc465dcdbb6a07b8e2b8d17f95c6
TEKSTI	058e1bf2944c40fec6c927e201d2346b728d717cc962079776e963fc452575f2
PAMJA	3e4ed8ed338082efc97c940990089171eed6c44657136594f9ae75f7a315a36c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1629244902c6ac8759ed361ef8f64f4266854224fb53cd4913ef064f32b029f1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1629244902c6ac8759ed361ef8f64f4266854224fb53cd4913ef064f32b029f1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)



English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le By Pass-11 Elbasanit, Himçit, Dy lotet nuk mjaftojne, Karaçaqi: Faza e trete buxhetohet ne 2027/FAZ ngre pikepyetje per denimet ndaj ish-krereve te UÇK-se: A jane propori fundit

Miku i Serbisë, “lot” për UÇK



17 Shtator 2026, 18:00Blog Nga Artur Ajazi

Ai që gjatë qeverisjes tij mbushte me karburant Serbinë, ai që shkelte konventat nderkombetare sa ishte president i vendit, ai që Serbinë e ka patur dhe vazhdon ta ketë “vend mik” paçka se ç’thotë, na derdhi “lot” për UÇK në Parlament. Madje u mbushi mëndjen edhe ca “axhamive” që ka sot në grupin e tij parlamentar se “duhej të mbronin Hashimin dhe tre liderët e tjerë kosovare, se sot Kuvendi duhej të fliste për vendimin e dënimit të tyre”. Dhe sejmënët ngriheshin një dhe nga një, dhe bënin si u thoshte miku i Sllobodanit.

Po si mund ta harrojnë shqiptarët atë periudhë, që na vuri “damkën e zezë” në Europë, si mund ti harrojnë shqiptarët maunet dhe çisternat me naftë që niseshin drejt kufirit me Serbinë, për të shpëtuar Sllobon nga embargo që i kishte vënë bota demokratike ? Ndaj, ajo që dëgjuam në Parlament ishte hipokrizia e rradhës, e një lideri me 140 flamurë, me 140 fytira, e cila nuk mund të besohet kurrësesi nga asnjë shqiptar. Ky vend ka mbi 36 vjet që merr “grushte fatale” nga ai njeri, që hiqet si “nacionalist, si patriot”, por në fakt erdhi në krye të Partisë Demokratike, dhe pastaj në presidencë me një mision të veçantë, mision që nis herët, para viteve 1990. Mision që vazhdoi tek takimi i bodrumit të një ambasade mike pas 22 Marsit 1992, nga ku seicili shtet nisi të kërkonte, emrin e ministrit të tij “të preferuar”. Agjenturat kishin hyrë dhe po punonin tanimë fare të qeta.

Sali Berisha pasi shkriu brenda 24 orëve, të gjithë rrjetin e agjenturës që ne kishim brenda dhe jashtë vendit (pasi e kishte udhëzim nga miqtë serbë) dhe i zëvendësoi ata me idiotë bio, që nuk dinin çfarë ishte shërbimi inteligjent, e përdori ish-SHIK-un, siç deshi. Kjo ishte dhe fatkeqësia e kombit. Vendi kishte rënë në duart e një njeriu, që kishte mision të shkatërronte nga themeli vendin, ekonominë, industrinë, bujqesinë, ushtrinë, policinë, shërbimin e fshehtë, të damkoste vendin si “partner i bindur i svallëve, dhe jo i europianëve”. Ai dëmtoi shumë edhe çështjen kosovare, mjafton të përmendim firmosjen e traktatit të Rambujesë, kur vetë Saliu bënte thirrje “kosovarë mos e firmosni”.

Ai gjithmonë e ka dëmtuar politikën e jashtme të Shqipërisë. Gjithmonë ka dëmtuar fatet e Kosovës, pasi në çdo moment delikat, që kalonte shteti më i ri në Europë, Sali Berisha dhe partia e tij, do të krijonin patjetër situata konfliktuale në Tiranë dhe rrethe. Atëhere, si ti besoj unë dhe shqiptarët, thirrjeve të tij në Parlament se “sot duhej të merreshim me vendimin e Hagës mbi 4 liderët e UÇK”. Gjithmonë ati ka qenë “shkopi nën rrota” mbi fatet e kombit, mbi progresin dhe integrimin, gjithmonë ai ka punuar dhe jetuar mbi zbatimin e “pikave të misionit” tij, që e ka zanafillën tutje, para 1990.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Në emër të popullit të Kosovës

15:20 Blog

10 arsye përse Kosova arriti këtu

12:50 Blog / 22 komente

[vendi mbi 1000 shatërvanë të një populli që merrte të katërtet e këmbës](#)

09:50 Blog / 6 komente

[O sa mir me ken... dëshmitar, o hej!!](#)

09:10 Blog / 37 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.